



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

Nr. 262 prot.

Vorë, më 14.05.2026

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE, DHE NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE**

Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit dhe Inspektimit të Pyjeve, Drejtoria e Administrimit të Pronave, Kadastrës dhe Resurseve Tokësore

Në mbështetje të ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 26 (i ndryshuar), VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, Bashkia Vorë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për pozicionin:

1 (një) Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit dhe Inspektimit të Pyjeve, Drejtoria e Administrimit të Pronave, Kadastrës dhe Resurseve Tokësore

Kategoria e pages III-B

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë

| | |
|---|-------------------|
| Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE: | 24.05.2026 |
| Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË: | 29.05.2026 |

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Drejton punen e sektorit në zbatim të detyrimeve të percaktuara në aktet ligjore dhe nenligjore në lidhje me praktiken e punes për inventarizimin, transferimin dhe regjistrimin e asetëve publike, përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të kërkuar, evidentimit në terren të pronës publike si dhe për administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave.
2. Ndjek punën që bëhet për zbatimin e akteve ligjore dhe nenligjore, në fushën e administrimit dhe përdorimit të pyjeve nga sektoret e bashkisë.
3. Merr masa për parashikimin në buxhet të shpenzimeve për regjistrimin e pyjeve sipas ligjit përkatës.
4. Ndjek zbatimin e vendimeve dhe urdheresave që harton Këshilli Bashkiak në fushën e administrimit dhe përdorimit të pyjeve.
5. Evidenton probleme që dalin nga veprimtaria e përditëshme si dhe shqetësime të ndryshme që ngrihen me shkrim nga qytetarët, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe i propozon eprorit, rrugëzgjdhjet përkatëse
6. Jep informacione mbi pyjet në përdorim ose në pronësi të Bashkisë.
7. Mbledh të dhëna për çështje që i ngarkohen ose janë në kompetencë të sektorit.
8. Organizon punën në sektor.
9. Harton planet e punës afatshkurtra/mesme/gjata, për sektorin dhe ia paraqet për miratim eprorit direkt.
10. Siguron respektimin e disiplinës në punë brenda sektorit.
11. Bën vlerësim periodik të specialisteve.
12. Kryen detyra të tjera të caktuara nga eprori direkt.
13. Raporton tek eprori direkt .

1 LEVIZJE PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civil të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet, pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master shkencor " në Inxhinieri Agro Mjedis (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës) për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b- Të kenë eksperiencë pune mbi 1 vit në shërbimin civil.
- c- Të kenë aftësi të mira komunikuese të punës në grup.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrimi (CV)
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c- Fotokopje e librezës së punës (te gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencë në punë)
- d- Fotokopje e letërnjoftimit (ID)
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- f- Vetdeklarim të gjendjes gjyqësore
- g- Dëshmi Penaliteti
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi dy vitet e fundit
- j- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar
- k- Çdo dokumentacion tjetër që verteton trajnimet kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (CV)

Dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet me postë ose në zyrën e potokollit, pranë Bashkisë Vorë brënda dates 24.05.2026

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Në datën **26.05. 2026** njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në Bashkinë Vorë do të shpallë në portalin “Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, në faqen e internetit të Bashkisë Vorë (nëse është e mundur teknikisht) dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Bashkinë Vorë, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos kualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

1. Ligji nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore’
2. Ligji 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar
3. Ligji Nr.9131, Date 8.9.2003 “Per Rregullat E Etikes Ne Administraten Publike”
4. Ligji Nr. 57/2020 “Për pyjet”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- d- Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Vorë do të shpallë fituesin në portalin “Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”,

Ne faqen e internetit të Bashkisë Vorë (nëse do të jetë e mundur teknikisht) dhe stendat e informimit të

publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail)

2 NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në Portalin "Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive", në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit publik në Bashkinë Vorë,

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- d- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master shkencor" në Inxhinieri Agro Mjedis.
(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës) për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- e- Të kenë eksperiencë pune mbi 1 vit në shërbimin civil.
- f- Të kenë aftësi të mira komunikuese të punës në grup.

2.2 KANDIDATËT QË APLIKOJNË DUHET TË DORËZOJNË DOKUMENTAT SI MË POSHTË:

- a- Jetëshkrimi (CV)
- b- Fotokopje e diplomës (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës) për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- c- Fotokopje e librezës së punës (te gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencë në punë)
- d- Fotokopje e letërnjoftimit (ID)
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- f- Vetdeklarim të gjendjes gjyqësore
- g- Dëshmi penaliteti
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi dy vitet e fundit
- j- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar
- k- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (CV)

Dorëzimi i dokumentave për ngritjen në detyrë duhet të bëhet me postë ose në zyrën e potokollit, pranë Bashkisë Vorë brenda datës 29.05.2026

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **04.06.2026** Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Vorë do të shpallë në portalin "Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive", në faqen e internetit të Bashkisë (nëse është e mundur teknikisht) dhe standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos kualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

kandidatët do të testohen në lidhje me:

1. Ligji nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore"
2. Ligji 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar

3. Ligji Nr.9131, Date 8.9.2003 “Per Rregullat e Etikes ne Administraten Publike”

4. Ligji Nr. 57/2020 “Për pyjet”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me :

- a) vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, përvojës e trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve individuale në punë;
- b) vlerësimin me shkrim;
- c) intervistën e strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- b) 40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c) 40 pikë për vlerësimin me shkrim.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore - Bashkia do të shpallë fituesin në portalin “Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe ne stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në adresën e email-it: info@bashkiavore.gov.al

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Drejtor

Mirjeta Mema

